



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL,
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 5868/2 Prot.,

Tiranë, më 23.11. 2023

SHPALLJE
TË LISTËS SË KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR
DREJTORIA RAJONALE E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT
QARKU DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19, pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të miratuar me Urdhrin nr.297 datë 23.6.2022. të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ligjit nr. Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 708 datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Ligjit nr. 10433 datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr. 128, datë 26.10.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Urdhërin Nr. 659 Prot., datë 2.2.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së për miratimin e Manualit të Rekrutimit ,

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në përfundim të procesit të verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacioneve të dorëzuara nga kandidatët për 1 (një) pozicion të lirë pune të shpallur në Drejtorinë Rajonale të AKU-së, Qarku Dibër në pozicionin:

- “1 (një) pozicion të lirë pune **“Specialist”** në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Dibër;

N J O F T O N:

1. Lista e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit është si vijon:
- Z. Leonard Muskaj
2. Intervista do të zhvillohet **më datë 24.11.2023, ora 9:00**, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, adresa Rruga “Bardhyl”, Ndërtesa Nr. 93, Njësia Administrative Nr. 3, Tiranë.
3. Kandidatët do të intervistohet në lidhje me:
 - Njohuri të përgjithshme për Kodin e Punës për të drejtat e detyrimet e punëdhënësit e punëmarrësit;
 - Njohuri mbi Ligjin Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar;
 - Njohuri mbi VKM-në nr. 708 datë 09.09.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”
 - Ligji Nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik”
 - Ligji Nr. 8730, datë 18.1.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përbashkët Gjyqësor” (Ndryshuar me ligjin Nr. 108/2016, datë 27.10.2016)
4. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
 - 50 pikë për jetëshkrimin/eksperiencën/pastërtinë e figurës
 - 50 pikë për intervistën me gojë.
5. Shpallja e fituesve bëhet në faqen zyrtare brenda 3 ditëve pune nga përfundimi i intervistës.
6. Çdo kandidat ka të drejtën për ankimim jo më vonë se 24 orë nga shpallja e listës së fituesve

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

EDMOND RRUSHI

